

20260290429

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 25 paragrafi (2) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi

P R O G R A M PËR TRAJNIME PËR AFTËSIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE PËR VITIN 2026

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026.

Neni 2

Trajnimet për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026 janë nga fushat, nënfushat dhe temat e mëposhtme të trajnimit:

I. PËR SHKOLLAT FILLORE

1. FUSHA: Mësimdhënia dhe të nxënët

Nënfusha: Realizimi i mësimi

Temat:

- Zbatimi i mjeteve digjitale për mësimdhënie interaktive (program me përparësi për mësimdhënësit e mësimi lëndor)
- Integrimi i temave ekologjike në mësim dhe zhvillimi i shprehive të gjelbra dhe sjelljes së përgjegjshme të nxënësit (programi me përparësi për mësimdhënësit e mësimi lëndor)
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe analitik përmes strategjive dhe teknikave të leximit me kuptim (program me përparësi për mësimdhënësit e mësimi klasor)
- Përdorimi i mjeteve të Intelgjencës artificiale në mësim
- Krijimi dhe përshtatja e materialeve digjitale mësimore
- Mësimi nga distanca me zbatimin e mjeteve për komunikim elektronik, me prezencë fizike ose të kombinuara me klasë virtuale

Nënfusha: Vlerësimi i nxënësve

Tema:

- Vlerësimi formativ dhe sumativ dhe dhënia e informatave kthyes cilësore, me kohë dhe konstruktive
- Hartimi i testeve dhe instrumenteve të tjera objektive për vlerësim me zbatim të kriterëve valide dhe të besueshme

Nënfusha: Njohja e nxënësve dhe përmbushja e nevojave të tyre

Tema:

- Zhvillimi i kompetencave për detektimin e interesave, aftësive dhe prirjeve të nxënësve dhe mbështetja e tyre përmes mentorimit, qasjes individuale dhe orientimit të zhvillimit arsimor dhe personal

2. FUSHA: Krijimi i mjedisit stimulues për të nxënë

Nënfusha: Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe stimulues për të nxënë

Tema:

- Zhvillimi i shkathtësive digjitale dhe sigurisë kibernetike te nxënësit përmes promovimit të përdorimit të sigurt, të përgjegjshëm dhe etik të teknologjive digjitale
- Njohja dhe veprimi ndaj sjelljeve të rrezikshme dhe forcimi i qëndrueshmërisë psikologjike te nxënësit.

3. FUSHA: Përfshirja sociale dhe arsimore

Nënfusha: Përfshirja sociale dhe arsimore

Temë:

- Mësimi projektues dhe hulumtues i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm përmes zbatimit të qasjes ndërdisiplinore dhe përfshirjes aktive të nxënësve

4. FUSHA: Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional

Nënfusha: Zhvillimi profesional

Temë:

- Këshillimi dhe orientimi profesional në kontekst digjital përmes përdorimit të mjeteve dhe platformave digjitale për informim, orientim dhe mbështetje të nxënësve

II. PËR SHKOLLAT E MESME

1. FUSHA: Mësimdhënia dhe të nxënët

Nënfusha: Realizimi i mësim

Tema:

- Përdorimi i mjeteve të Intelejencës artificiale në mësim
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe analitik përmes leximit me kuptim – zbatimi i strategjive për analizë, interpretim dhe vlerësim të llojeve të ndryshme të teksteve në mësim

Nënfusha: Vlerësimi i nxënësve

Tema:

- Vlerësimi formativ dhe sumativ dhe dhënia e informatave kthyes cilësore, me kohë dhe konstruktive për nxënës

Nënfusha: Njohja e nxënësve dhe përmbushja e nevojave të tyre

Tema:

- Teknikat dhe mjetet e avancuara për këshillim në karrierë për orientim individual dhe mbështetje të nxënësve (program prioritar për mësimdhënës – këshilltarë të karrierës)

2. FUSHA: Krijimi i mjedisit stimulues për të nxënë

Nënfusha: Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe stimulues për të nxënë

Tema:

- Zhvillimi i shkathtësive digjitale dhe sigurisë kibernetike te nxënësit përmes përdorimit të sigurt, të përgjegjshëm dhe etik të teknologjive digjitale

Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën vijuese pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-2601/1

11.2.2026

Shkup

Ministre e Arsimit

dhe Shkencës,

Prof. Dr. **Vesna Janevska**, d.v.